



LISTA KONTROLLUESE E PUNËDHËNËSIT PËR VETËVLERËSIM

PJESA 2:	RREZIQET NË PUNË
Tema 2.1.	RREZIQET FIZIKE
Nën-tema 2.1.7.	FUSHAT ELEKTROMAGNETIKE
Ligji / rregulloret përkatëse:	• Ligji Nr.04/L-161/2013 për sigurinë dhe shëndetin në punë; • Rregullore (MPMS) Nr.08/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga rreziqet e lidhura me fushat elektromagnetike në vendin e punës; • Rregullore (MPMS) Nr.02/2021 për vlerësimin e riskut në vendin e punës.
Shkurtesa:	• MPSM – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale • VKE – Vlerat Kufi të Ekspozimit
Fushëveprimi i listës kontrolluese:	Kjo listë kontrolli është e zbatueshme në të gjitha industritë dhe sektorët nën fushën e zbatimit të Ligjit Nr.04/L-161, për "Sigurinë dhe Shëndetin në Punë", pavarësisht nga forma e organizimit, lloji i pronësisë dhe arsyet mbi të cilat puna ose trajnimi kryhen në vendet e punës ku ekziston rrezik për shëndetin për shkak të fushave elektromagnetike.
Përdorimi i listës së kontrollit:	Nëse përgjigjeni "Po" në një pyetje, ju lutemi kaloni në pyetjen tjetër, në rast se përgjigjeni "Jo" bëni vërejtje që mund të ndërmerren veprime për të përmbushur kërkesat ligjore.

Nr.	Pika e kontrollit	Po	Jo	Vërejtje për zbatim
	PARA VIZITËS NË LOKACION / VENDET E PUNËS			
	<i>* Meqenëse bëhet fjalë për vetë inspektim, apo vetëvlerësim të situatës në subjektin tuaj nga rreziqet fizike – fushat elektromagnetike, do të ishte mirë që ekipi i inspektimit paraprakisht ta ketë në shqyrtim dokumentin e vlerësimit të riskut, atëherë do të ketë njohuri të afërta me rreziqet dhe masat e përcaktuara, të cilat duhet apo është dashur të ndërmerren nga punëdhënësi për mënjanimin, respektivisht minimizimin e tyre.</i>			
	INSPEKTIMI I LOKACIONIT / VENDEVE TË PUNËS			

	* Bëhuni shembull; respektoni rregulloret e shëndetit dhe sigurisë në lokacionin / vendet e inspektuara të punës * Gjatë vizitës në vend punishte / vendin e punës, duhet t'i kushtoni vëmendje të punësuarve që janë të ekspozuar në vende të punës me rreziqe nga fushat elektromagnetike duke ju sqaruar anët negative nga përdorimi i pajisjeve të cilat janë burim i këtyre fushave të dëmshme. * Kushtojini vëmendje shembujve të mirë dhe jo të mirë. * Bisedoni me të punësuarit, tregohuni miqësor, shpjegoni dhe këshilloni për të drejtat e tyre sipas legjislacionit.			
1.	A është kryer vlerësimi i hollësishëm i riskut sipas legjislacionit përkatës? Ligji Nr.04/L-161/2013, Neni 16 Rregullore (MPMS) Nr.02/2021			
2.	Në përputhje me legjislacionin përkatës, a është siguruar vlerësimi i çdo riskut nga fushat elektromagnetike për të punësuarit dhe nëse është e nevojshme, a është siguruar matja ose llogaritja e niveleve të fushave elektromagnetike ndaj të cilave janë ekspozuar të punësuarit? Rregullore (MPMS) Nr.08/2017, Neni 6, 1			
3.	A i kushtohet vëmendje e veçantë kushteve kur përdoren pajisje ose instalime elektrike me fuqi të lartë, siç janë instalime të furnizimit me energji elektrike, instalime transmetuese të valëve elektromagnetike, pajisje industriale të saldimit, pajisje mjekësore të destinuara për prodhimin e fushave elektromagnetike etj.? Rregullore (MPMS) Nr.08/2017, Neni 6, 1			

4.	A është siguruar vlerësimi i risqeve, identifikimi dhe vlerësimi i fushave elektromagnetike në vendin e punës, duke marrë parasysh udhëzimet përkatëse? Rregullore (MPMS) Nr.08/2017, Neni 6, 2			
5.	A kryhen vlerësimi i ekspozimit, matjet dhe llogaritjet nga shërbimet ose persona të kualifikuar dhe të njohur nga Autoriteti kompetent sipas udhëzimeve përkatëse? Ligji Nr.04/L-161/2013, Neni 8 Rregullore (MPMS) Nr.08/2017, Neni 6, 4			
6.	A mbahet evidencë për të punësuarit që kanë deklaruar përdorimin e pajisjeve mjekësore të implantuara aktive ose pasive, të tilla si rregulluesit e ritmit të zemrës ose pajisjeve të vendosura në trup, si pompat e insulinës, ose për gratë shtatzëna? Rregullore (MPMS) Nr.08/2017, Neni 6, 5			
7.	A sigurohet për vlerësimin e risqeve vëmendje e veçantë lidhur me dispozitat e nenit 6, paragrafi 6, pikat 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10 dhe 11? <i>Rregullore (MPMS) Nr.08/2017</i> • <i>Për nivelin e frekuencës, kohëzgjatjes dhe llojit të ekspozimit, shpërndarjen në trupin e të punësuarit, efektit të drejtpërdrejtë biofizik, efektit mbi sigurinë dhe shëndetin e të punësuarve në risk të veçantë, si gratë shtatzëna, të punësuarit që përdorin pajisje mjekësore të implantuara në trup, informacionet nga ekzaminimet shëndetësore, informacionit të ofruar nga prodhuesi i pajisjes.</i>			
8.	A e dokumentohet vlerësimi e riskut, ku përfshihen të dhënat e siguruar nga vlerësimi, matja ose llogaritja e nivelit të			

	ekspozimit dhe ku përcaktohen masat që duhen marrë në përputhje me nenin 7 të kësaj rregullore Nr.08/2017? Rregullore (MPMS) Nr.08/2017, Neni 6, 8			
9.	A ruhet në një formë të përshtatshme dokumentacioni për vlerësimin e riskut, që lejon konsultimin e tij të mëvonshëm? Rregullore (MPMS) Nr.08/2017, Neni 6, 8			
10.	A është nënshkruar vlerësimi i riskut nga ekspertët që e kryejnë atë? Rregullore (MPMS) Nr.08/2017, Neni 6, 8 • <i>Ekipi inspektues duhet komform rregullores Nr.02/2021, të verifikojë se a janë nënshkruar të gjithë ata që kanë marrë pjesë në vlerësimin e riskut, përfshirë edhe mjekun specialist të mjekësisë së punës.</i>			
11.	A merr me shkrim nga ana e punëdhënësit eksperti që kryen vlerësimin e riskut, të dhënat e nevojshme dhe të domosdoshme për hartimin e vlerësimit? Rregullore (MPMS) Nr.08/2017, Neni 6, 8			
12.	A përditësohet rregullisht vlerësimi i ekspozimit, sipas afateve dhe në çdo rast kur ka pasur ndryshime të rëndësishme, të cilat mund ta bëjnë atë të pavlefshëm, ose kur rezultatet e mbikëqyrjes shëndetësore janë parashikuar? Rregullore (MPMS) Nr.08/2017, Neni 6, 9 Rregullore (MPMS) Nr.02/2021			

13.	A ndërmerren veprime të nevojshme për të siguruar që rreziqet shëndetësore që krijohen nga fushat elektromagnetike në vendin e punës të shmangen ose të zvogëlohen në minimum? Rregullore (MPMS) Nr.08/2017, Neni 7, 1			
14.	A hartohet dhe zbatohet një plan veprimi që përfshin masat teknike, organizative për parandalimin e tejkalimit të VKE, nëse nivelet e veprimit tejkalohen? Rregullore (MPMS) Nr.08/2017, Neni 7, 2			
15.	Gjatë hartimit dhe zbatimit të planit të veprimit a merren parasysh në veçanti masat e parapara nga Nenin 7, në paragrafin 3, pikat 3.1; 3.2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8; 3.9 dhe 3.10 të rregullores Nr.08/2017, për të shmangur ose zvogëluar rreziqet nga fushat elektromagnetike? Rregullore (MPMS) Nr.08/2017, Neni 7, 3			
16.	A i përfshinë plani veprimit masat teknike dhe organizative për të parandaluar çdo rrezik për të punësuarit? Rregullore (MPMS) Nr.08/2017 Neni 7, 4			
17.	A janë vendosur shenja të përshtatshme, në përputhje me legjislacionin përkatës në vendin e punës mbi bazën e vlerësimit të ekspozimit, në vendet e punës ku të punësuarit mund të ekspozohen ndaj fushave elektromagnetike që tejkalojnë nivelet e veprimit? Rregullore (MPMS) Nr.08/2017 Neni 7, 5			

18.	A merren masa mbrojtëse specifike për mbrojtjen e të punësuarve, si trajnimi për përdorimin e mjeteve teknike, tokëzimi i objekteve të punës, lidhja e të punësuarve me objektet etj.? Rregullore (MPMS) Nr.08/2017, Neni 7, 6			
19.	A identifikohen dhe dokumentohen arsyet përse janë tejkaluar VKE-të e efekteve në shëndet dhe VKE-të e efekteve ndijore dhe njofton me shkrim autoritetin kompetent? Rregullore (MPMS) Nr.08/2017, Neni 7, 7			
20.	Në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.04/L-161 për Siguri dhe Shëndet në Punë, a siguroheni që të punësuarit që mund të ekspozohen ndaj rreziqeve që shkaktohen nga fushat elektromagnetike në punë dhe përfaqësuesit e tyre, të marrin informacionin dhe trajnimin e nevojshëm në lidhje me rezultatet e vlerësimit të ekspozimit dhe veprimet e ndërmarra? Rregullore (MPMS) Nr.08/2017, Neni 8			
21.	Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë, a merren masat e përshtatshme për konsultimin dhe pjesëmarrjen e të punësuarve, veçanërisht lidhur me vlerësimin e riskut të ekspozimit dhe masat e ndërmarra ose që duhen ndërmarrë për shmangien ose zvogëlimin e ekspozimit? Rregullore (MPMS) Nr.08/2017, Neni 9			
22.	A sigurohet mbikëqyrje shëndetësore për çdo të punësuar që ekspozohet ndaj fushave elektromagnetike në përputhje me legjislacionin përkatës?			

	Rregullore (MPMS) Nr.08/2017, Neni 10			
--	---------------------------------------	--	--	--